



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
Departamenti i Biologjisë

Kandidat:

Diellza Gashi

Titulli i punimit:

**FLORA VASKULARE NATYRORE DRUNORE DHE
SHKURRORE NË RRAFSHIN E DRENICËS**

Punim i Masterit

Mentor:

Prof. Dr. Elez Krasniqi

Prishtinë, 2024

ABSTRAKT

Në kuadër të florës vaskulare mund të dallojmë tre forma jetësore të bimëve: drunore, shkurre dhe barishtore. Sipas Raunkier 1934 (Rexhepi, F. 1994), në klasifikimin e formave jetësore, vend me rendësi kanë edhe format jetësore drunore dhe shkurre të cilat futen në kuadër të fanerofiteve (Phanerophyta (P)).

Bimët drunore dhe shkurret paraqesin forma jetësore me rendësi për florën dhe vegjetacionin. Ato e pasurojnë biodiversitetin dhe janë pjesë e rendësishme e ekosistemeve. Sikur edhe zonat tjera në territorin e Republikës së Kosovës, edhe Rrafshi i Drenicës është zonë e pasur në aspektin e florës dhe vegjetacionit. Në kuadër të bimësisë në Rrafshin e Drenicës, në veçanti vërehet prani e drurëve dhe shkurreve, të cilat ishin qëllimi këtij hulumtimi. Gjatë hulumtimit të realizuar në periudhën pranverë-vjeshtë të vitit 2024 është hulumtuar diversiteti i llojeve bimore drunore dhe shkurre në Rrafshin e Drenicës nga Pjetërshtica deri në Dobrashec.

Rrafshi i Drenicës karakterizohet me klimë kontinentale (me 9.60C temperature mesatare vjetore si dhe me 692 mm reshje mesatare vjetore). Substrati është karakteristik për zonat e ultësirave dhe fushore-kodrinore sikur edhe në zona tjera të Kosovës. Mbulesa bimore (vegjetacioni) poashtu është karakteristik për zonat e ultësirave dhe ato fushore kodrinore. Përgjatë Rrafshit të Drenicës kalon Lumi Drenicë përgjatë të cilit kemi vegjetacion karakteristik për rrjedhat ujore. Sipas metodologjisë për hulumtimin e vegjetacionit nga Braun Blanquet 1964 (Rexhepi, F. 1994), vegjetacioni i Rrafshit të Drenicës përfaqësohet nga vegjetacioni i rrjedhave ujore, vegjetacioni i livadheve, i kullotave, i pyjeve gjetherënëse (të cilat si pasojë e faktorit antropogjen janë fragmentare) dhe vegjetacioni ruderal.

Fjale kyçe: flora, drurët, shkurret, Drenica, Kosova.

ABSTRACT

Within the vascular flora, we can distinguish three life forms of plants: woody, shrubby and herbaceous. According to Raunkier 1934 (Rexhepi, F. 1994), in the classification of life forms, woody and shrubby life forms also have an important place, which are included in the phanerophytes (Phanerophyta (P)).

Woody plants and shrubs represent life forms of importance for flora and vegetation. They enrich biodiversity and are an important part of ecosystems. Like other areas in the territory of the Republic of Kosovo, the Drenica Plain is also a rich area in terms of flora and vegetation. Within the vegetation in the Drenica Plain, the presence of trees and shrubs is particularly noticeable, which was the purpose of this research. During the research conducted in the spring-autumn period of 2024, the diversity of woody and shrubby plant species in the Drenica Plain from Pjetërshtica to Dobrashec was investigated.

The Drenica Plain is characterized by a continental climate (with an average annual temperature of 9.60C and an average annual rainfall of 692 mm). The substrate is characteristic of lowland and hilly plain areas, as well as in other areas of Kosovo.

The plant cover (vegetation) is also characteristic of lowland and hilly plain areas. The Drenica River runs along the Drenica Plain, along which we have vegetation characteristic of watercourses. According to the vegetation research methodology by Braun Blanquet 1964 (Rexhepi, F. 1994, 2007), the vegetation of the Drenica Plain is represented by the vegetation of watercourses, the vegetation of meadows, pastures, deciduous forests (which as a result of the anthropogenic factor are fragmentary) and ruderal vegetation.

Keywords: flora, trees, shrubs, Drenica, Kosovo.